



**Broshurë
informuese**

Broshurë informuese

Vlerësimi Pedagogjik i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta



Lokacioni i Komisionit vlerësues
Komuna e Podujevës
Rr. Nuhi Gashi, 11000- Podujevë
Email: selman.gashi@ks-gov.net
Tel: +383 1 45 876 397

Çka është vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta?

Fëmijët me nevoja të veçanta, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, duhet ti nënshtrohen një vlerësimi pedagogjik që përcakton nevojat e tyre arsimore. Pas caktimit të këtyre nevojave, fëmijët me nevoja të veçanta do ta kenë më lehtë përfshirjen cilësore në edukim.

Pse duhet të vlerësohen fëmijët me nevoja të veçanta?

Bazuar në Udhëzimin Administrativ me nr. 16/2017 për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta të lëshuar nga MASH, fëmijët me aftësi të kufizuara duhet t'i nënshtrohen vlerësimit profesional të nevojave të tyre arsimore, për të identifikuar nevojat e tyre arsimore dhe për të krijuar kushte të përshtatshme që plotësojnë ato nevoja.



Pse është e nevojshme të vlerësohen fëmijët me nevoja të veçanta?

Sepse vlerësimi pedagogjik përcakton:

- Institucionin në të cilin fëmija do të vijojë edukimin;
- Llojin e mësimdhënies;
- Shërbimet mbështetëse;
- Pajisjet dhe instrumentet e nevojshme administrative;
- Shërbimet rehabilituese;
- Transportin e përshtatshëm.


Kush është ekipi vlerësues?

Përbërja e ekipit vlerësues:

- Selman Gashi- koordinator
- Valdet Plakolli -psikolog
- Remzije Hoxha-Gërguri, mësimdhënëse mbështetëse
- Dafina Sylja, pedagoge
- Ardiana Blakçori, punëtore sociale

Anëtarë tjerë që mund të ftohen nga ekipi vlerësues janë:

- Mësimdhënësi i klasës;
- Eksperti varësisht nga lloji i nevojës së veçantë të fëmijut;
- Prindi apo kujdestari ligjor i fëmijut duhet të jetë prezent dhe konsultativ gjatë gjithë kohës së vlerësimit.



Kush mund të identifikojë fëmijët që kanë nevojë për vlerësim:

- Kopshtet/Shkollat;
- Qendrat e Mjekësisë Familjare;
- Qendrat për Punë Sociale;
- Organizatat e ndryshme të Personave me Aftësi të Kufizuara;

Çfarë duhet të bëjmë pas identifikimit?

- Të këshillojmë prindërit dhe familjarët të inicojnë procedurën e vlerësimit.

Kush mund të inicojë vlerësimin?

- Prindi ose Kujdestari ligjor i fëmijës;
- Drejtori i shkollës

Ku inicohet procedura e vlerësimit?

- Në komunë- Drejtoria Komunale për Arsim

Kush është përgjegjës për procesimin e mëtutjeshëm të inicimit?

- Koordinatori për Arsim Gjithëpërfshirës në kuadër të Drejtorisë Komunale për Arsim.

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ARSIMIMI

- Na jep dije dhe njohuri;
- Na jep identitet dhe vlera njerëzore;
- Mundëson integritet social;
- Ulë paragjykimet dhe rritë socializimin;
- Ju mundëson fëmijëve me nevoja të veçanta të zhvillojnë jetë normale sikurse fëmijët tjerë
- Ju mundëson fëmijëve me nevoja të veçanta të zhvillojnë potencialin e tyre përkundër limiteve eventuale.

